

## CONTENTS / PËRMBAJTJA

### AmCham News/Lajme

AmCham Members Talk Taxes with Minister Ahmetaj	
Biznesi i AmCham-it Flet për Taksat me Ministrin Ahmetaj .....	06-09
AmCham Discusses with Director in Charge of Taxes for Large Businesses	
Dhoma Amerikane Flet me Drejtoreshen e Biznesit VIP .....	10-12
New Members/Anëtarë të rinj .....	13
The Board of AmCham Met with Minister Sonila Qato	
Bordi i AmCham-it Takohet me Ministren e Sipërmarrjes .....	14-15
AmCham Business Forum with PricewaterhouseCoopers Audit	
AmCham Forum Biznesi me PricewaterhouseCoopers Audit .....	16-19
IPR Committee Group Discusses Market Inspection Law	
Komiteti i IPR Diskuton për Ligjin e Inspektimeve të Tregut .....	20-23
Tax and Legal Committee meets	
Mblidhet Komiteti i Taksave dhe Ligjeve .....	24-25
Best Practices Visits	
Vizitë për Praktikantë më të Mira .....	26-29
AmCham Addresses Productive Activities Parliamentary Committee	
Dhoma Amerikane Flet në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese .....	30-31

### Member News/Lajme anëtarësh.....32-33

Business Matching Platform	
Platforma Business Matching .....	34-35

### Economy/Ekonomi

Amnesty Law and its Implementation in Practice	
Ligji i Faljes dhe Zbatimi i Tij në Praktikë .....	36-39
Fiscal Package 2018	
Paketa Fiskale 2018 .....	40-43

## AMCHAM BOARD



### President

Mark C. CRAWFORD  
*Aksioner International  
Securities Brokerage*



### Vice-President

Genti DACI  
*ABCCom*



### Secretary

Genci LIKOSKENDAJ  
*CCS Computer & Copier  
Systems*



### Treasurer

Alketa URUÇI  
*Boga & Associates*

### Board Members



Adrian SHEHU  
*TCN*



Avni PONARI  
*SIGAL Uniqa Group Austria*



Elton ÇOLLAKU  
*Financial Union  
Tirana-Western Union*



Loreta PEÇI  
*Pricewaterhouse Coopers  
Audit*



Artan BOZO  
*Bozo & Associates*



Enio JAÇO  
*CBS Creative Business Solutions*



Brandt W. HOFFMAN  
*G&H Partners*



Enida BEZHANI  
*AmCham Albania*



The American Chamber of Commerce  
wishes the American community and all  
its members

*Happy*  
**Thanksgiving**  
*Day!*

.....

The Chamber invites all of you to become part of the initiative of the American Bank of Investments (ABI) to volunteer time or help with traditional food for the Thanksgiving lunch for 60 people in need at the social center (Soup Kitchen) in Kombinat on November 23, 2017.

.....



## SUSTAINING MEMBERS

## ANETARË PRESIDENCIALE

		 ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND		
				
				
				
				
				
				
				
				



FISCAL PACKAGE 2018

# AMCHAM MEMBERS TALK TAXES WITH MINISTER AHMETAJ

**THE GIST OF THE FISCAL PACKAGE IS THE APPLICATION OF VAT ON ALL BUSINESSES WITH AN ANNUAL TURNOVER THRESHOLD OF UP TO 2 MILLION LEK (~\$17,256).**



**F**inance and Economy Minister Arben Ahmetaj has introduced the new Fiscal Package to the American Chamber of Commerce in a working luncheon with the AmCham representatives. The meeting focused on taxes set to be applied in 2018, Albania’s business climate, the needed business-government dialogue and also issues AmCham members face in their day-to-day operations. AmCham President Mark Crawford said during the meeting that working to build positive reforms is very important. “We work hard, but we do not always achieve what we want,” Crawford said. “Even though it might be late in the game, we will do our best to provide our comments on the Fiscal Package, believing that this might not provide immediate solutions for some business concerns, but it will create a more sustainable fiscal future.”

Minister Ahmetaj apologized for the short time allowed for comments on the Fiscal Package as to abide with the timelines set for a parliamentary process, and explained some of the novelties the latest package brings, clarifying that changes include both the tax rates and procedures. “For the first time we are introducing the self-correction element in the system, giving businesses the opportunity to correct mistakes without being punished,” said Ahmetaj. The gist of the Fiscal Package is the application of VAT on all businesses with an annual turnover threshold of up to 2 million lek (~\$17,256). The issue of VAT application on all turnover thresholds has turned into a hot topic for the business community. Speaking about the new VAT threshold, minister Ahmetaj mentioned that the new system will include only 9,000 businesses out of

70,000 businesses that currently are not included in the VAT application scheme.

“That means that street vendors, municipal-run markets and artisans will be exempted and considering that currently there are about 70,000 businesses out of the VAT reporting system, only 9,000 businesses will be included in the system. The remaining 61,000 will continue to be exempted because of their low turnover of below 2 million lek- said Ahmetaj.”

The finance minister said the good news with a positive impact on the economy is that VAT on tourism will be reduced. “Another important change has been made on the tourism sector with new 5-star hotels,” he said. The draft budget unveils VAT on all newly-built chain-branded hotels will be at 6 percent for all services they offer within their facili-

Paketa e re Fiskale 2018

# BIZNESI I AMCHAM

## FLET PËR TAKSAT ME MINISTRIN AHMETAJ



### KRYEFJALA E PAKETËS FISKALE

**KA QENË APLIKIMI I  
TVSH-SË PËR TË GJITHA  
BIZNESET QË OPEROJNË  
DERI NË NIVELIN E  
XHIROS 2 MILION LEKË  
NË VIT.**

**D**homa Amerikane e Tregtisë është prezantuar me Paketën e re Fiskale nga vetë Ministri Ahmetaj, në takimin Drekë Pune me biznesin e saj. Takimi ka patur në fokus taksat që do të aplikohen në 2018-ën, klimën e biznesit dhe dialogun që duhet të ekzistojë, si dhe çështje që biznesi i AmCham-it kalon në çdo ditë të aktivitetit të vet.

“Ne punojmë, por jo gjithmonë mund të realizojmë atë që duam. Është e rëndësishme në fakt që të ndihmohet për të ndërtuar reforma pozitive. Edhe pse me vonesë, ne do të bëjmë të pamundurën për të dhënë komentet tona mbi Paketën Fiskale, duke besuar se kjo nuk do të zgjidhë disa kërkesa biznesi për momentin, por do të krijojë një të ardhme fiskale më të qëndrueshme” - u shpreh Mark Kroford, Presidenti i Dhomës Amerikane gjatë takimit.

Ministri Ahmetaj, duke kërkuar ndjesë

për kohën e shkurtër në dispozicion për komente mbi Paketën Fiskale, ka prezantuar në takim risitë që ajo sjell duke qartësuar ndryshimet që prekin jo thjesht nivelin e taksave, por edhe ato procedurale. “Për herë të parë po fusim në sistem elementin e vetkorrigimit, duke i dhënë mundësi biznesit të ndreqë gabimin pa u penalizuar” - tha Ministri Ahmetaj.

Por kryefjala e Paketës Fiskale ka qenë aplikimi i TVSH-së për të gjitha bizneset që operojnë deri në nivelin e xhiros 2 milion lekë në vit. Çështja e aplikimit të TVSH-së në të gjitha nivelet ka qenë mjaft e debatueshme në komunitetin e biznesit. Ministri Ahmetaj duke folur mbi vendosjen e TVSH-së ka përmendur faktin se në këtë skemë do të përfshihen vetëm 9 mijë nga 70 mijë biznese që janë jashtë skemës së TVSH-së.

“Kjo do të thotë që përjashtohen ambulancat, tregjet e bashkive, zejtarët dhe nëse sot janë gati 70 mijë biznese që janë jashtë skemës së deklarimit të TVSH-së, gjithsej brenda skemës do të hyjnë vetëm 9 mijë. 61 mijë do të mbeten sërish të përjashtuar për shkak të nivelit të tyre të ulët të xhiros nën 2 milionë - u shpreh Ministri Ahmetaj.”

Si një lajm pozitiv dhe që do të japë ndikim në ekonomi, z. Ahmetaj ka përmendur uljen e TVSH-së për sektorin e turizmit. “Ndryshim i rëndësishëm është ai që prek sektorin e turizmit, përkatësisht hotelet e reja me 5 yje”. Kështu sipas informacionit, TVSH-ja do të jetë 6 për qind për të gjitha hotelet që ndërtohen rishtazi me 5 yje, që janë ‘brand name’, për të gjitha shërbimet brenda mureve të tyre. Këtë lehtësi e përfitojnë

ties. The incentive will be available only for chain-brand hotels recognized by the World Trade Organization. In a parallel move, luxury hotels will be exempted from corporate income tax for ten years.

### **BUSINESS CLIMATE**

The campaign against tax evasion and expectations to improve the business climate in the country by formalizing the informal sector of the economy was the focus of Mr. Ahmetaj speech. Currently, the nationwide campaign against informality is in its third stage.

**“THE GOAL IS NOT TO COLLECT REVENUES, BUT TO BE AS CLOSE AS POSSIBLE TO YOU. WHEN WE ACT ARROGANTLY, YOU ARE THE ONES WHO LOSE. WHEN WE SHOW MODESTY AND DEDICATION, BOTH THE ECONOMY AND YOU WIN,” AHMETAJ SAID.**

The anti-informality package has envisaged the establishment of a system that monitors all the VAT chains, extending the inclusion into the VAT scheme to businesses with an annual turnover of more than Leke 2 million. That means street vendors, municipal-run markets and artisans will be excluded, which means that most of the currently excluded 70,000 businesses will continue to remain outside the VAT



scheme.

“Allow me to provide you with some data. When we carried out online inspections in the past four months, we reclassified 563 small businesses into big ones. Online inspections during the past 20 days as part of this campaign have increased the number of businesses reclassified into big ones to 920. There were some 4,300 online inspections and only 120 field inspections. All of this because we do not want to bother and put pressure on you,” Minister Ahmetaj

told business representatives at the meeting, commenting on the progress of the campaign against informality. He further added: “The processing of public services documentation shows that nine types of documents were requested 590,000 times. By cutting down the number of these documents, which can now be obtained on the e-Albania portal, we have saved businesses 65 working days. Of course this is a process which will gradually improve.”

Minister Ahmetaj also added that some types of licenses which up to now were issued by the institution he leads will now be issued by other official bodies that operate closer to the businesses, making it easier to obtain them.

### **2018 DRAFT BUDGET**

The 2018 draft budget will guarantee the targeted 4.5 % growth for the first three years of the governing term and a 5.5 percent growth rate in the final year. It will enable deep reforming of the economy and fiscal consolidation, according to the Minister.

“After four years, the relationship with the IMF will be of a monitoring kind, as we have overcome the fiscal crisis and can conduct the fiscal consolidation on our own,” Mr. Ahmetaj said. “Public debt is at a 66 percent of the GDP and we have not increased it, with no

negative impact on the economy and having a surplus and even paying off the previous government’s debts.”

The government has promised to further formalize the economic system during this term. Part of the project has been financed under the 2018 budget and it will continue. “Initially, we will continue with the fiscal cadastre, and when the multifunctional cadastre is created, we will fold the fiscal cadaster into it,” Minister Ahmetaj said.

### **2018 FISCAL PACKAGE**

An important change is the one with an impact on the tourism sector, involving new five-star hotels, which will see the application of a 6 percent VAT on all services offered within the facilities of newly-built chain-brand hotels. The incentive is available for all luxury chain-brand hotels on the WTO list. In addition, luxury hotels will be exempted from the corporate income tax for ten years.

The property tax on households will be applied at 0.05 percent of the property’s value. The tax will initially be applied only on buildings and later extend to construction sites and agricultural land. As far as business facilities are concerned, the property tax rate will be three times higher. Under the legal provision, a household owning an apartment at a market value of €100,000 will pay €50 in annual property tax for next year. The new formula changes the methodology on the calculation of this tax from a fixed tax rate applied on the building’s surface measured in square meters, to a tax rate as a percentage on the building’s market value.

The excise duty on cigarettes will also increase under an earlier plan. The increase was halted last year, but is back on the excise duty hike agenda, bringing the excise duty rate on par with regional countries. Only Macedonia, where the tobacco industry is a state-run sector, is an exception in the region. The customs duties have decreased and will continue to do so especially for trade with EU countries, lifting them for the products that have been agreed upon.

### **AMCHAM MEMBER CONCERNS**

AmCham members used the meeting with Mr. Ahmetaj to discuss some of the issues they face in their everyday business operations. VAT refunds, tax rates, the economic operators’ status, customs reference prices, insurance premium tax, issues regarding the implementation of the VAT law and permits on bonded warehouse were some of the concerns raised by the AmCham members.

Answering a majority of the questions, Minister Ahmetaj said that issues that were not addressed at the meeting could be further addressed by the experts of the Ministry of Finance and Economy.



vetëm markat e hoteleve të listuara si 'brand name' nga OBT-ja. Paralelisht, hotelet luksoze përfitojnë përjashtim nga tatim fitimi për dhjetë vjet.

## KLIMA E BIZNESIT

Aksioni antiinformalitet dhe pritshmëritë për të përmirësuar klimën e biznesit në vend duke futur në skemën e formalitetit atë pjesë informale të ekonomisë, kanë qenë në qendër të fjalës së z. Ahmetaj. Aktualisht, aksioni kundër informalitetit është në fazën e tretë.

**"QËLLIMI I TIJ ËSHTË JO TË MBLEDHIM TË ARDHURA, POR TË AFROHEMI SA MË SHUMË QË MUNDEMI PRANË JUSH. KUR BËJMË ARROGANTIN, ATA QË HUMBASIN JENI JU. KUR NE KEMI MODESTINË DHE PËRKUSHTIMIN, ATA QË FITONI JENI JO VETËM JU, POR DHE EKONOMIA"-U SHPREH Z. AHMETAJ.**

Paketa antiinformalitet ka parashikuar që të krijojë sistemin për të patur nën kontroll të gjitha hallkat, duke e shtrirë nivelin e TVSH-së deri tek bizneset në 2 milion lekë xhiro vjetore. Kjo do të thotë që përjashtohen ambulancat, tregjet e bashkive, zejtarët dhe sot janë gati 70 mijë biznese që janë jashtë skemës së deklarimit të TVSH-së.

"Më lejoni të jap disa statistika. Kur ne kontrolloam gjatë 4 muajve bizneset nga zyra, bëmë të mundur që 563 biznese të kalojnë nga biznesi i vogël në biznesin e madh. Vetëm në këto 20 ditë të ushtrimit të kontrollit nga zyra në kuadër të këtij aksioni, numri i kompanive që kanë kaluar në biznesin e madh ka shkuar në 920 biznese. Janë bërë 4300 kontrolle nga zyra dhe vetëm 120 tek kompanitë. E gjitha kjo sepse nuk duam t'ju bezdisim dhe të krijojmë presion" - tha Ministri Ahmetaj në lidhje me zhvillimin e aksionit kundër informalitetit.

Kështu rezulton se nga inventarizimi i dokumentacionit për shërbimet publike janë kërkuar gjatë një viti 590 mijë herë 9 lloje dokumentesh. Duke shkurtuar këto dokumente, që sot mund të gjenden në portalin e-albania, ne i kemi kursyer biznesit 65 ditë pune. Sigurisht që ky është një proces që përmirësohet vazhdimisht. Disa lloje licencash që deri dje janë dhënë nga Ministri i Ekonomisë për të lehtësuar punën e biznesit do të jepen nga institucione të thjeshta dhe më pra-

në biznesit.

## PROJEKT BUXHETI 2018

Projektbuxheti i 2018-ës do të sigurojë rritjen e planifikuar me 4.5 për qind për tre vitet e para qeverisëse dhe me 5.5 për qind në vitin e fundit. Do të mundësojë reformim të thellë në ekonomi dhe konsolidim fiskal.

"Pas katër vitesh, raporti me FMN-në do të jetë monitorues pasi ne e kaluam krizën fiskale dhe mund ta bëjmë vetë konsolidimin fiskal. Borxhi publik është në nivelin e 66 përqindshit, dhe ne nuk e kemi shtuar duke mos ndikuar në ekonomi, duke dalë me balancë sufiçit dhe duke paguar madje borxhet e qeverisë së kaluar" - u shpreh z. Ahmetaj.



Gjatë këtij mandati, qeveria ka premtuar se do të bëjë fiskalizimin e sistemit. Një pjesë e këtij projekti është i financuar që në buxhetin e 2018-ës dhe do të vazhdojë dhe më tutje. "Së pari, do të fillojmë me kadastrën fiskale dhe kur të jetë krijuar edhe kadastra multifunkionale do t'i dorëzojmë kadastrën fiskale" - tha Ministri Ahmetaj në lidhje me këtë fakt.

## PAKETA FISKALE 2018

Ndryshim i rëndësishëm është ai që prek sektorin e turizmit, përkatësisht hotelet e reja me 5 vje.

TVSH 6 për qind për të gjitha hotelet që ndërtohen rishtazi me 5 vje që janë 'brand name', për të gjitha shërbimet brenda mureve të tyre. Këtë lehtësi e përfitojnë vetëm markat e hoteleve të listuara si 'brand name' nga OBT-ja. Paralelisht, hotelet luksoze përfitojnë përjashtim nga tatim fitimi për dhjetë vjet.

Taksa e pronës për familjet do të jetë 0.05 për qind e vlerës së pronës. Fillimisht ajo do të zbatohet vetëm për ndërtesat, më vonë do të shtrihet edhe tek truallit dhe toka bujqësore. Për ndërtesat e biznesit,

taksa do të jetë tre herë më shumë. Sipas dispozitës së re ligjore, një familje e cila ka një apartament me vlerë tregu 100 mijë euro, vitin e ardhshëm do të paguajë 50 euro taksë prone. Është ndryshuar metodologjia e llogaritjes së kësaj takse, nga një taksë fikse që bazohet në sipërfaqet e ndërtesës e shprehur në metër katrorë, në taksë në përqindje që aplikohet mbi vlerën e tregut të ndërtesës.

Akciza e cigareve do të rritet, por vjen si pasojë e një plani të vjetër. Ne ndaluar vjet dhe i jemi kthyer sërish planit të akcizës, duke e çuar nivelin e akcizës së duhanit në atë të rajonit. Në rajon bën përjashtim vetëm Maqedonia që e ka sektor shtetëror. Taksat doganore janë ulur

dhe do të vazhdojnë të ulen sidomos me vendet e BE-së, duke i çuar në zero mallrat për të cilat kemi rënë dakord.

## ÇËSHTJE TË ANËTARËVE TË AMCHAM

Ndërkaq, anëtarët e Dhomës Amerikane kanë shfrytëzuar takimin për t'i folur z. Ahmetaj mbi disa problematika që kanë hasur në aktivitetin e tyre. Rimbursimi i TVSH-së, niveli i taksave, statusi i operatorit ekonomik apo dhe referencat doganore, kanë qenë çështje të diskutuara nga anëtarët e Dhomës Amerikane. Taksa mbi primin e ngritur nga industria e sigurimeve, referencat doganore, problematika të zbatimit të ligjit të TVSH-së, apo lejet për magazinat doganore, kanë qenë të gjitha problematika që anëtarët e Dhomës Amerikane i kanë ngritur gjatë takimit.

Z. Ahmetaj i është përgjigjur një pjesë të mirë të pyetjeve, duke lënë edhe mundësinë e vazhdimit të diskutimit me specialistët e tij, për çdo çështje që nuk mundi të merrte përgjigje në takim.



# AMCHAM DISCUSSES INSPECTIONS AND INFORMALITY WITH DIRECTOR IN CHARGE OF TAXES FOR LARGE BUSINESSES

The VIP Business Group of the American Chamber of Commerce in Albania met with the Large Taxpayers Director, Enkeleda Pipa Brahaj, to exchange information on how this category of businesses can deal with tax inspections and its expectations with regards to the Action against informality. The discussion included key elements to take into consideration during a tax audit.

*The tax director focused on the risk analysis applied to audit large businesses. There are four areas of focus for audits: services, trade, construction and manufacturing. According to Ms. Pipa, inspectors are not looking to fight informality within this business category, as large companies tend to be the ones that follow the rules, but tax officials are trying to discipline all business categories to fight high informality in the economy.*

*Speaking about the efforts being made in the fight to formalize the economy, Ms. Pipa focused on the task and role of the tax inspectors. She asked AmCham members to report any and all abusive behavior to increase transparency in the audit process.*



Large companies in Albania employ about 115,000 people and ensuring that they declare the current full remuneration of the employees is one of the audit elements.

Speaking about the risk analysis, Ms. Pipa added that the chain of transactions that these businesses have had over a certain period of time will be used as a factor to assess whether an audit will take place.

“We will check their progress from year to year and also the transactions they have had with retail businesses,” she said.

The Director spoke about the importance of the entire chain of transactions—purchase documents, the application of reference prices, the application of the wholesale price, etc. “The chain of transactions will be verified by the regional directorate, to look into the details of the transaction prices, inventories and prices in the sectors of trade and production,” said Ms. Pipa.

She added that it is important to note that the audits and inspections to fight informality will be mostly desk-top-based, and the field inspections will serve primarily to provide feedback and advise businesses on tax regulations.

**AmCham, through the Chair of its Tax and Legal Committee, Alketa Uruçi, raised concerns on issues AmCham members have encountered during audits by tax inspectors. Ms. Uruçi requested on behalf of AmCham that inspectors be properly trained and instructed about the goal of a visit to the business premises. “There needs to be an education process to identify high risk activities and point out issues without burdening the normal activity of the taxpayer,” she said. Increasingly, the tax audit main issue is to reduce the timeline of inspection at the**

**business location and shift it to the tax office.**

“I can not say that we were not of the same opinion on the cases where the results were not those expected by the government. I wish the inspections were normal and not like a war. I wish that inspectors were better trained. We see inspectors that don’t know what they are looking for. Two-three months are wasted on both sides with audits that ultimately find nothing wrong,” Ms. Uruçi said.

She added that it is important for members of AmCham that during audits inspectors take action based solely on the tax law procedures and respect them in a transparent way.

“To shorten bureaucratic procedures, you must contact us ahead of time. Even requests via e-mail from the Tax Administration become bother some at times, as they come all at once,” Ms. Uruçi said.

# DHOMA AMERIKANE

## FLET ME DREJTOREN E BIZNESIT VIP MBI KONTROLLET TATIMORE DHE INFORMALITETIN

Bizneset VIP të Dhomës Amerikane janë takuar me Drejtoreshën e Tatimpaguesve të Mëdhenj, znj. Enkeleda Pipa Brahaj, për të shkëmbyer informacionin mbi mënyrën se si ky biznes përballet me inspektimet, pritshmëritë nga fushata kundër informalitetit dhe elementët kryesorë që ata duhet të kenë në konsideratë kur i vjen një kontroll tatimor.

*“Drejtorja e Tatimpaguesve të Mëdhenj është përqendruar në fjalën e saj në analizën e riskut që do të aplikohet për të kontrolluar biznesin e madh. Katër do të jenë sektorët në të cilët do të përqendrohet kontrolli; shërbimet, tregtia, ndërtimi dhe prodhimi. Sipas znj. Pipa, inspektorët nuk po kërkojnë të luftojnë informalitetin në këtë kategori biznesi që është dhe më e rregullta, por po kërkojnë të disiplinohen të gjitha veprimet e tyre me kategori të tjera të biznesit që e kanë informalitetin e lartë.*

*Duke folur për përpjekjet që po bëhen në luftën për të formalizuar ekonominë, znj. Pipa u ndal gjatë dhe në detyrën dhe rolin e inspektorit. Ajo kërkoi nga anëtarët që të raportojnë çdo sjellje abuzuese të tyre, për të rritur transparencën e këtij procesi.*



Biznesi i madh është sektori që punëson 115 mijë të persona dhe deklarimi i pagave të tyre reale do të jetë një nga elementët e kontrollit. Duke folur për analizën e riskut, znj. Enkeleda Pipa Brahaj bëri të ditur se zinxhiri i transaksioneve që këto biznese kanë patur gjatë një periudhe të caktuar kohe, do të përdoret dhe si bazë për kontrollin e tyre.

“Ne do të kontrollojmë ecurinë e tyre nga viti në vit dhe transaksionet që kanë me bizneset me pakicë” - u shpreh znj. Pipa. Kreu i DTM-së ka bërë të ditur gjatë forumit edhe rëndësinë e zinxhirit të transaksioneve, që nga dokumentet e blerjes, aplikimi i çmimeve të referencës, aplikimi i çmimeve me shumicë. “Zinxhiri i transaksioneve do të verifikohet në drejtorinë rajonale, për të parë me detaje çmimet e transaksioneve, inventarët dhe çmimet e sektorit për tregtinë e prodhimin” - ka deklaruar znj. Pipa.

Është e rëndësishme të theksohet se kontrolli në kuadër të aksionit kundër informalitetit, do të kryhet më së shumti nga zyrat dhe kontrollet në terren do

të shërbejnë pikë së pari për t’iu dhënë bizneseve një *feed back* dhe për t’i këshilluar.

**Dhoma Amerikane nëpërmjet Kryetares së Komitetit të Taksave dhe Ligjeve, znj. Alketa Uruçi, ka ngritur problematikat që anëtarët e Dhomës kanë hasur gjatë proceseve të kontrollit nga inspektorët tatimorë. Znj. Uruçi ka kërkuar në emër të Dhomës që inspektorët të jenë të trajnuar dhe të instruktuar lidhur me synimin që kanë gjatë kontrollit - vizitës fiskale. Aksioni duhet të shërbejë për njohjen e thelluar të aktivitetit të tatimpaguesve me risk të lartë dhe identifikimin e problematikave, pa rënduar aktivitetin normal të tatimpaguesit. Gjithnjë në kuadër të kontrolleve tatimore, është e rëndësishme të ulet kohëzgjatja e kontrollit në vend, duke u paraprirë me një**

**vlerësim nga zyra të natyrës së aktivitetit dhe synimeve të kontrollit tatimor.**

“Nuk mund të mos them se ishim në të njëjtat pozita, ku rezultatet nuk ishin ato që prishte qeveria. Do të doja që kontrollet të ishin konstante dhe jo luftë. Do të doja që inspektorët të ishin më të trajnuar. Shohim inspektorë që nuk dinë çfarë kërkojnë. Harxhohen 2-3 muaj kohë nga të dyja palët për kontrolle, për të cilat në fund nuk gjejnë asgjë” - u shpreh znj. Uruçi. Është e rëndësishme për anëtarët e AmCham-it që gjatë një kontrolli, inspektorët të kenë në konsideratë ligjin e procedurave tatimore dhe ta respektojnë atë me transparencë.

“Kjo do të shkurtonte procedurat burokratike, duhet të na lajmëroni më parë. Edhe kërkesat më e-mail nga Administrata Tatimore bëhen të bezdisura, nuk duhet të vijnë njëkohësisht të gjitha” - tha Kryetarja e Komitetit të Taksave dhe Ligjeve në AmCham, znj. Uruçi.

# AMCHAM MEMBERS

# WE WANT LOWER TAXES AND TRANSPARENCY IN AUDITS



For AmCham members, a tax audit does not pose an issue as long as it happens once, it includes all elements, is transparent and comes forward with realistic conclusions. But these audits often happen repeatedly and with the intention of finding faults and imposing administrative measures instead of advising on how to correct the

problems. AmCham member companies in the transport sector have raised concerns on the issue, asking Director Pipa to require inspectors to be more precise and to eliminate forms of abuse. "They won't leave without issuing a fine, even when there is nothing wrong. This is upsetting to us," said an AmCham member representative.

Another problem of this sector is the reimbursement of VAT. "You delay reimbursements, and we don't have the needed liquidity to continue our work," another business representative said. On the same issue of audits, other members said that it would have been an easier burden on businesses if the

government introduces this year a reduction in the tax burden to go at least to the levels of a flat tax of 10 percent. Representatives at the forum said this would give them more breathing room to increase investments. Large businesses are not against making sure there is compliance with tax legislation but they have raised concerns about the use of tax receipts. "We have problems with small businesses not accepting the receipts we need to officially offload the goods we sell. How are we to handle all those goods on our tax balance sheets? It would be nice to extend audits at all levels," said a representative of the AmCham VIP businesses.

# ANËTARËT E AMCHAM

# DUAM TAKSA MË TË ULTA DHE TRANSPARENÇË NË KONTROLLE

Për anëtarët e AmCham-it, kontrolli tatimor nuk do të përbëjë një problem nëse ai ndodh njëherë, përfshin çdo element, bëhet transparent dhe në fund del mbi konkluzione realiste. Por ndodh vazhdimisht që një kontroll ka në fokus gjetjen e gabimit dhe jo kontrollin praktik këshillues, dhe më pas, edhe masën administrative nëse është e nevojshme. Kompanitë anëtare nga sektori i automjeteve e kanë ngritur këtë, duke i kërkuar znj. Pipa që të kërkojë nga Inspektorët të jenë më të saktë dhe të eliminojnë format e abuzivizmit. "Nuk largohen pa vendosur gjobë edhe kur çdo gjë është komplet në rregull. Kjo na mërzit" - u shpreh një prej anëtarëve të Dhomës.

Një tjetër problematikë e këtij sektori, ishte dhe rimbursimi i TVSH-së. "Ju na vononi rimbursimet duke na bllokuar

likuiditete të nevojshme për të vazhduar punën" - u shprehën ata.

Ndërkohë, duke i qëndruar sistemit të kontrollove, anëtarët e tjerë kanë deklaruar se do të kishte qenë një barrë më e lehtë për ta, nëse qeveria do të prezantonte këtë vit ulje të barrës fiskale, për të shkuar të paktën në nivelet e taksës së sheshtë 10 për qind. Do të na jepte më shumë fymëmarje dhe mundësi për investime u shprehën ata.

Biznesi i madh nuk është kundër kontrollit, por ata kanë ngritur problemin e shkarkimit të faturave tatimore. "Nuk na i pranojnë në biznesin e vogël. Ku duhet



ta shkarkojmë ne gjithë atë mall? Do të ishte mirë që kontrolli të shtrihet në të gjitha nivelet" - u shprehën bizneset VIP të Dhomës Amerikane.



## NEW MEMBERS ANËTARË TË RINJ



### Blue Eye Water sh.a.

Blue Eye Water sh.a. was established 2 years ago in Tirana, Albania and it encompasses a broad range of businesses. However, its main activity is the production of soft drinks and water.

Blue Eye Water aims to introduce in Albania the experience of its US partners, who are leaders in this field and have shared their best practices starting from production and all the way to serving the final product to the customers. Blue Eye Water is by now investing and will be on the Albanian market and other international markets, as it is in the process of negotiations with very well-known international partners, who will sell its high-quality products, which will be produced with the highest technology of packaging in order to preserve and protect the environment.

### Blue Eye Water

Kompania 'Blue Eye Water Sh.a.' është një kompani e themeluar në Tiranë, 2 vjet më parë, dhe ka si objekt një gamë të gjerë biznesesh, por në plan të parë ka prodhimin e të gjitha produkteve soft drink dhe të ujit. Kompania 'Blue Eye Water Sh.a.' ka partnerë në Amerikë, të cilët kanë një eksperiencë shumëvjeçare në këtë fushë, duke filluar nga prodhimi deri tek konsumatori, dhe kërkojnë të prezantohen në lartësinë dhe cilësinë sa më maksimale të mundshme. Ata janë në fazën e investimit dhe për një kohë jo shumë të gjatë mendojnë të dalin në tregun shqiptar dhe në tregje të tjera ndërkombëtare, ku janë duke negociuar për marrëveshje me partnerë ndërkombëtarë me shumë emër në tregun botëror, që të tregtojnë dhe të prezantohen tek ata me produktet tyre. Këto produkte do të jenë me standarde të cilësisë europiane dhe të asaj amerikane dhe do të ruajnë standardet më të larta për mbrojtjen e ambientit dhe të mjedisit, si edhe të ambalazhimit të produkteve.



### Gustoso

Gustoso is the newest company in the field of gastronomy, which took its first steps into the catering business as of June 1st, 2013. Gustoso was born thanks to an incredibly long experience of its staff in the catering and restaurant business, with chefs that are capable of organizing big events both indoors and outdoors. Thanks to the meticulousness of its chefs, Gustoso shows great care for detail, innovation, quality, purity and variety. Gustoso was born to fill a void in the industry. Being healthy will never go out of style, and just because a party is thrown, or a dinner is served, it does not mean that we need to sacrifice either our health or our enjoyment of the food.

### Gustoso

'Gustoso' është kompania më e re në treg në fushën e gastronomisë, që ka filluar të punojë për herë të parë si catering në 1 qershor 2013. 'Gustoso' ka lindur si rrjedhojë e eksperiencës së gjatë të stafit të saj në restorante dhe shërbime të ndryshme cateringu, me shefa të njohur, të specializuar në organizimin e eventeve në ambiente të hapura e të mbyllura. Falë punës skrupuloze të shefave, 'Gustoso' është e orientuar drejt detajeve, inovacionit, cilësisë, pastërtisë dhe llojshmërisë. 'Gustoso' lindi për të plotësuar një hapësirë boshe në treg. Të qenit i shëndetshëm nuk do të dalë kurrë nga moda, ndaj ju nuk keni pse të hiqni dorë nga kënaqësia që të jep ushqimi i shëndetshëm, për shkak të një feste ku merrni pjesë apo të një darke që ju serviret.



### Iliria Services

Iliria Services shpk is located in Tirana and is established with the aim of offering its customers – mostly focused in business and fiscal advisory services – its experience of a team determined and committed to provide accurate solutions, guidance and reliable schemes to legal frames and various situations of business activities:

- Assistance in establishing a new company in an emerging market, advisory for best and most appropriate long-term solutions;
  - Key options in terms of fiscal and accounting issues;
  - Advisory services in developing a sustainable business plan and providing the necessary information for decision-making;
  - Assistance in building up a business, including legal arrangements;
  - Internationalization and relocation,
  - Assistance in the process of contracts' negotiations, providing the best fiscal solutions determined by law.
- Its motto is: The success of our clients is the route to our success.

### Iliria Services

'Iliria Services Sh.p.k.' me qendër në Tiranë, është themeluar me qëllim që t'iu ofrojë klientëve të saj konsulencë në fushën e financave dhe orientimin drejt biznesit. Stafi i saj me eksperiencë zotohet të ofrojë zgjidhje dhe orientim të kujdesshëm për problematika ligjore dhe situata të ndryshme që bizneset hasin në punën e tyre të përditshme si:

- Asistencë në themelimin, regjistrimin dhe lançimin e një kompanie në treg, këshillim për zgjidhje afatgjata,
  - Mundësi zgjidhjesh në çështjet financiare dhe të kontabilitetit,
  - Shërbime këshilluese në zhvillimin e një plani biznesi të qëndrueshëm dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm për vendimmarrje;
  - Asistencë në strukturimin e biznesit, duke përfshirë edhe marrëveshjet ligjore;
  - Ndërkombëtarizim dhe zhvendosje;
  - Asistencë në procesin e negociatave të kontratave, duke ofruar zgjidhjet më të mira fiskale të përcaktuara nga ligji.
- Motoja e saj është: Sukses i klientëve tanë është rruga e suksesit tonë.

# BOARD OF AMCHAM MET WITH MINISTER SONILA QATO



**T**he Ministry for Entrepreneurship Protection will do more than just “protect” businesses from any abuse or problems that stem from the incorrect implementation of the law procedures, explained Minister Sonila Qato, who leads the new State Ministry that has in its scope of work the protection of businesses. She shared in details her idea of a new era for the business environment.

In order to get acquainted, share information on the objectives and the way that this Ministry would collaborate with businesses, the representatives of the Board of AmCham, met Mrs. Sonila Qato and talked about key issues that affect businesses nowadays.

The Board members in attendance proposed that the Ministry should “scan” the various industry sectors, because, as observed in practice, often the organic laws clash with the general

laws and the business wastes a lot of time settling this “misalignment”. But the key drive for the moment, remains the Action against Informality.

**SPEAKING ABOUT IT, THE MINISTER WAS OF THE OPINION THAT IT SHOULD BE MORE OF AN EDUCATIONAL TYPE RATHER THAN HAVE A “PUNITIVE” CHARACTER. SHE IDENTIFIED THE NEED FOR AN OPEN, FRIENDLY AND SINCERE DIALOGUE, GIVEN THE GREAT IMPACT THAT THE ENTREPRENEURSHIP HAS IN BOOSTING THE ECONOMY AND CONTRIBUTING TO ADDRESSING SOCIAL ISSUES AS WELL.**

Talking about this cooperation, AmCham Board members suggested that a Ministry, named the Ministry of Entrepreneurship Support would represent better the scope of work of

this Ministry.

On her part, Minister Qato shared a general overview on how the Ministry will work closely with business organizations to improve the business climate. This Ministry will play the role of the Advocate for the businesses. It intends to act as the interlocutor, between the government and businesses, addressing on the spot issues with the public administration and addressing any wrong procedures. It will follow an open-door policy of cooperation with the businesses and organizations like AmCham that represent business interests in the country. Its goal will be to address any concerns from the businesses directly with the relevant Ministers, rather than with their administration, as to be more efficient, while the PM is also kept directly updated of all the concerns.

Since its establishment, this Ministry has been faced with a large number of requests and complains from businesses, which means that they are in need of serious help. This shows trust, but also raises a lot of expectations towards the Ministry. AmCham shared its experience of the Tax and Legal Committee, the members of which are very capable distinguished experts, working pro bono for the Chamber. AmCham is readily available to collaborate with the Ministry and help with expert advice accordingly, when needed.



# BORDI I AMCHAM-IT TAKOHET ME MINISTREN E SIPËRMARRJES



**M**inistrja e Mbrojtjes së Sipërmarrjes do të bëjë më shumë se sa të mbrojë nga abuzimet apo nga aplikimi gabim i procedurave. Ministrja Qato ka shpjeguar në detaje, idetë e saj për një epokë të re në drejtimin e Ministrisë që supozohet të mbrojë sipërmarrjen.

Për t'u njohur me njëri-tjetrin dhe për të shkëmbyer informacionin mbi objektivat dhe mënyrat e bashkëpunimit, përfaqësuesit e Dhomës Amerikane takuan znj. Qato dhe folën rreth problematikave që afektojnë biznesin.

Duke folur me Ministren Qato, përfaqësuesit e Bordit të Dhomës Amerikane, i kërkuan asaj që të “skanohej” veprimtaria e disa sektorëve sepse ndodh shpesh që ligji organik të ketë përplasje me ligjin qendror dhe bizneset detyrohen të shpenzojnë kohë për të zgjidhur këtë keqkuptim. Por, kryefjala e momentit mbetet pa dyshim

**DUKE FOLUR PËR AKSIONIN KUNDËR INFORMALITETIT, MINISTRJA QATO PREZANTOI IDENË E SAJ, SE DUHET TË KETË MË SHUMË FORMA TË EDUKIMIT TË BIZNESIT SE SA TË NDËSHKIMIT. AJO FOLI PËR NEVOJËN E NJË DIALOGU TË HAPUR E KONSTRUKTIV, DUKE PATUR PARASYSH IMPAKTIN E MADH QË BIZNESI KA NË ZHVILLIMIN E EKONOMISË, POR EDHE NË ADRESIMIN E ÇËSHTJEVE SOCIALE.**

aksioni kundër informalitetit.

Duke folur pikërisht për këtë lloj bashkëpunimi, përfaqësuesit e Dhomës Amerikane sugjeruan që emri i Ministrisë nga Ministria e Mbrojtjes së Sipërmarrjes duhet të bëhet Ministri e Mbështetjes së Sipërmarrjes, për të përfaqësuar më mirë qëllimin e këtij institucioni.

Nga ana e saj, Ministrja Qato bëri një prezantim të përgjithshëm mbi mënyrën se si Ministria që ajo drejton do të punojë ngushtë me organizatat e biznesit, për të përmirësuar klimën e biznesit në vend. Ministria duhet të luajë rolin e avokatit për bizneset. Kjo nënkupton që ajo do të luajë rolin e një ndërmjetësi mes qeverisë dhe biznesit, duke adresuar drejt çështjet që vijnë nga zbatimimi gabim i procedurave dhe problemeve me administratën publike. Kjo do të ndiqet nga një politikë e deryve të hapura në bashkëpunimin me organizatat e biznesit si Dhoma Amerikane. Qëllimi është që të adresojë çdo shqetësim që vjen

nga biznesi drejtpërdrejt tek Ministrat përkatës, në vend që t'i drejtojnë tek administratat e këtyre ministrive. Kjo do të bëhet me qëllimin për të qenë sa më efikas në zgjidhjen e problemeve, ndërkohë që vetë kryeministri do të mbahet i përditësuar me të gjitha këto shqetësime.

Që prej krijimit, Ministria e Sipërmarrjes është përballur me disa kërkesa dhe shqetësime nga biznesi, çka tregon se biznesi ka nevojë për ndihmë. Kjo demonstroi besim, por në të njëjtën kohë tregon dhe pritshmërinë e madhe që ka biznesi nga kjo Ministri. Dhoma Amerikane ndau eksperiencën që vjen nga Komiteti i Taksave dhe Ligjeve, anëtarët e së cilës janë ekspertë të njohur dhe të aftë që punojnë vullnetarisht për Dhomën. Dhoma Amerikane do të jetë e gatshme të bashkëpunojë me Ministrinë dhe të ndihmojë nëpërmjet këtyre ekspertëve me këshilla kur të jetë nevoja.





# AMCHAM BUSINESS FORUM

WITH PRICEWATERHOUSECOOPERS  
AUDIT



**THE POSITIVE DEVELOPMENT IS THAT THE NEW VAT LAW HAS BEEN HARMONIZED WITH THE EUROPEAN UNION VAT DIRECTIVE AND AS A RESULT TRANSACTIONS SUBJECT TO VAT ARE TREATED THE SAME WAY AS IN ALL EU MEMBER COUNTRIES FROM THE FISCAL VIEWPOINT.**

## HOW TO APPLY TAX ACCURATELY WHILE CONDUCTING SALES

The Law on the Valued Added Tax, which has been in place since January 2015, has brought new challenges in its implementation for both taxpayers and the tax administration.

The implementation of this law when it comes to price discounts, gifts or bonuses in the supply process has been a controversial issue during tax inspections.

However, the challenge lies in providing detailed information to businesses, so that they are able to apply the legislation correctly on their own, make use of the easier procedures, meet document requirements and discuss the matter as clearly as possible with the tax authorities.

To address the importance of this in-

formation, the American Chamber of Commerce in Albania and PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. organized a Business Forum on “How to Apply Tax Accurately while Conducting Sales”

Speaking about the goal of the Business Forum, Loreta Peçi, a PricewaterhouseCoopers Audit partner, explained the importance of sharing information on the tax treatment and being represented through a unified stance to the tax authorities for a fairer implementation of the law.

PwC experts Lorena Gega and Mirjeta Emini elaborated during the forum on how to deal with seasonal price reductions, promotional events and products that are no longer intended for sale or that are damaged and lost during production, transportation and warehousing. PwC experts also addressed the question on how to treat samples and

# AMCHAM FORUM

## BIZNESI ME PRICEWATERHOUSECOOPERS AUDIT



LAJM I MIRË ËSHTË SE LIGJI I RI I TVSH-SË ËSHTË HARMONIZUAR ME DIREKTIVËN EUROPIANE TË TVSH-SË, DHE KËSHU TRANSAKSIONET SUBJEKT I TVSH-SË TRAJTOHEN NJËSOJ NGA PIKËPAMJA FISKALE SI NË TË GJITHA VENDET E BE-SË.

### SI TË APLIKOJMË DREJT TATIMET NË PROCESIN E SHITJEVE

Ligji i TVSH-së, i cili ka hyrë në fuqi në janar 2015, ka sjellë sfida të reja në aplikimin e tij si për tatimpaguesin ashtu edhe për administratën tatimore. Pjesë e diskutueshme gjatë kontrolleve tatimore ka qenë pikërisht aplikimi i këtij Ligji, kur vjen fjala për uljet e çmimit, dhuratat apo bonuset në procesin e furnizimit.

Megjithatë, sfida qëndron në informimin në hollësi të bizneseve, në mënyrë që vetë ata të jenë të aftë të aplikojnë sa më drejt legjislacionin, lehtësirat që ai sjell, si dhe të dokumentojnë kërkesat e tij dhe të argumentojnë në mënyrë sa më të qartë përpara autoriteteve tatimore. Pikërisht për rëndësinë që ka ky informacion, është folur në Forumin

e Biznesit të organizuar nga Dhoma Amerikane me PricewaterhouseCoopers Audit, me temë “Si të Alikojmë Drejt Tatimet në Procesin e Shitjeve”.

Duke folur për qëllimin e këtij Forumi Biznesi, znj. Loreta Peçi, Partnere pranë PricewaterhouseCoopers Audit, ka sqaruar se është e rëndësishme që të ndajmë informacion mbi trajtimin fiskal dhe të prezantohemi tek autoritetet tatimore me një qëndrim të unifikuar, në zbatimin sa më të drejtë të Ligjit.

Gjatë takimit, ekspertët e PwC-së, znj. Lorena Gega dhe znj. Mirjeta Emini kanë referuar mbi trajtimin e reduktimit sezonal të çmimeve, aktivitetet promociionale si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave apo trajtimin e firove dhe humbjeve gjatë prodhimit, transportit e magazinimit. Ekspertët e PwC-së, i kanë dhënë përgjigje gjithashtu edhe pyetjes se si trajtohen mostrat dhe dhuratat me vlerë të vogël në perspektivën e Ligjit të TVSH-së. A do paguhet TVSH-ja në këtë rast?



low-value gifts in the frame of the VAT law. Will VAT be paid in these cases?

How can we deal with losses during production, transportation and warehousing and what is the technical and tax documentation that businesses should take into consideration in these cases? All the questions that AmCham businesses had on these issues were addressed during this meeting.

### WHAT THE LAW ENVISAGES ON GIFTS AND SPONSORSHIP-RELATED EXPENDITURES

In its entirety, the new VAT law envisages that in order for a transaction to be subject to VAT, it has to be carried out in exchange of a payment. What about the cases when there is no payment? The law envisages that in some cases when transactions are not carried out in return for payment, they are nevertheless treated as transactions subject to VAT. The law also introduces new, easier procedures, not previously envisaged by the older VAT law. Businesses were not previously eligible to providing samples or low value gifts during their operations for promotional purposes or to boost their market presence.

Under the current VAT legislation, all those incentives are available.

Speaking at the forum, Ms. Gega explained all the cases when a transaction is taxable and the circumstances the law envisages for cases when certain supply does not constitute a taxable transaction subject to VAT. Thus, samples distributed to consumers free of charge are not considered taxable sales subject to VAT, but these products have to be directly related to the normal operations of the taxpayer. At the same time, the samples could at first glance be similar to other products in the taxpayer's inventory, but those samples must have distinctive labels that separate them from the products intended for sale. Taxpayers are also allowed to distribute free gifts in order to boost their business. In order for these gifts not to be considered as sales subject to VAT, they have to be below the individual value of 2,000 lek (\$17.20).

By applying those criteria, the taxpayer

is eligible for VAT deductions during the purchase, import or production of these products. Meanwhile, their transfer is not treated as supply of goods in return for payment, and as a result neither the issue of a VAT tax receipt, nor the adjustment of purchase for VAT is required.

Looking at the Law on Profit Tax, spending incurred from giving away products in promotional campaigns can be deducted, when the donation of these gifts is carried out during a campaign approved by the Stakeholder Assembly or the Administrator for a campaign on which there is a drafted strategy and minutes of meeting are recorded in writing on the kind and total number of products to be given away.

The profit tax law also envisages tax incentives regarding representation expenditures, allowing for the recognition of these expenditures as tax deductible at an amount of up to 0.3 percent of the annual turnover.

On the other hand, the limit to tax deductible sponsorship is calculated on earnings before taxes, specifically 15 percent on sponsorships for sports, educational or cultural events and 3 percent on sponsorships for any other event.

### HOW ARE PRICE DISCOUNTS DEALT WITH WHEN IT COMES TO VAT AND PROFIT TAX

Që nga dhjetori i 2016-ës, EasyPay është partneri zyrtar i 'Ria Money Transfer', kompani amerikane e cila renditet si operatori i tretë në botë për transfertat e parave. Tashmë, për herë të parë në Shqipëri, kushdo mund të marrë e të dërgojë para tek të afërmit në një nga pikat e EasyPay, që ofrojnë shërbimin Ria me komisionet më të ulëta në treg.

Bashkë me shumëfishimin e shërbimeve novatore, EasyPay vazhdon edhe me rritjen e vlerësimeve. Përveç çmimeve vendase, së fundi EasyPay u nominua si kompania e parë shqiptare në *European FinTech Awards* dhe arriti të rezultonte si një nga tre *'fintechs'* më të mirë në kontinent, në kategorinë e gjithëpërfshirjes financiare. Kjo shënon edhe fillimin e ndërkombëtarizimit të EasyPay jashtë kufijve të Shqipërisë.

**Fondacioni Abraham Linkoln** i Shqipërisë është një organizatë jo-fitimprurëse që ekziston për të zhvilluar udhëheqës përmes arsimimit të shkëlqyer për mirëqenien e popullit shqiptar. Përgjatë këtyre 20 viteve, mbi 60,000 studentë kanë përfutuar trajnime për gjuhën, kompjuterin dhe biznesin.

Në muajin tetor, u zhvilluan disa aktivitete në kuadër të 20 vjetorit të themelimit të tij. Tema e këtij përvjetori ishte 'Mirënjohja' pasi ajo shprehte më qartë ndjenjën dhe realitetin e këtij momenti, siç u shprehën edhe vetë Presidentja dhe Themeluesi e Kryetari i Bordit të Drejtorëve.

"Me rastin e njëzet vjetorit të Fondacionit Abraham Lincoln të Shqipërisë dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për studentët, prindërit, klientët dhe miqtë për mbështetjen dhe besimin që na kanë dhënë gjatë viteve. Në veçanti jam mirënjohëse dhe dua të vë në pah përkushtimin dhe dedikimin e vazhdueshëm të stafit tonë të mrekullueshëm. Puna e palodhur dhe vlerat e tyre kanë bërë që Linkoln të jetë ky që është sot, një institucion arsimor i shquar, i përkushtuar ndaj fuqizimit dhe pajisjes së njerëzve për të aspiruar dhe për të arritur gjëra më të mëdha.

Ne ende kemi shumë për të bërë dhe njëzet vjet janë vetëm fillimi i një rruge të gjatë.

Shpresojmë se duke mësuar dhe punuar së bashku, do të ndërtojmë një të ardhme më të mirë për Shqipërinë." - Aida Repishtit, Presidente, Qendrat Linkoln Shqipëri

"Mirënjohje - duam të shprehim mirënjohje për gjithë mirësinë që kemi marrë gjatë këtyre 20 vjetëve. Jemi bekuar me një staf mësimdhënës dhe administrativ të jashtëzakonshëm. Jemi bekuar me mirëbesimin që na kanë dhënë studentët dhe klientët për dy dekada.

Jemi bekuar edhe me mbështetjen e zyrtarëve vendas. Nuk marrim asgjë si të mirëqenë, por i shprehim nderimin secilit që e meriton. Mbi të gjitha pohojmë se çdo dhuratë e mirë dhe e përsosur vjen nga Perëndia i qiellit. Ka qenë dhe vazhdon të jetë privilegji ynë t'u shërbejmë njerëzve të këtij vendi madhështor në zhvillim." - Robb Provost, Themelues dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve.

**PwC Albania and Kosovo**, në bashkëpunim me autoritetet tatimore të Shqipërisë dhe Kosovës, organizoi ditën e hënë, 13 nëntor, në Prishtinë një event në kuadër të zbatimit të rregullave të Transferimit të Çmimit.

Ky aktivitet pati për qëllim informimin mbi rregullat e Transferimit të Çmimit në shtetet përkatëse, problematikat e hasura në praktikë nga tatimpaguesit si dhe problematikat e hasura nga Autoritetet Tatimore në kryerjen e kontrolleve tatimore..

Autoritet Tatimore shqiptare u përfaqësuan nga drejtoresha e Drejtorisë Rajonale Tatimore -Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Znj. Enkelejda Pipa, ndërsa autoritetet tatimore kosovare u përfaqësuan nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Z. Sakip Imeri. Për të adresuar në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse problematikat e hasura në praktikë, PwC Albania and Kosovo ftoi ekspertët e saj rajonale për të ndarë eksperiencën e tyre.

PwC Albania and Kosovo numëron një sërë eventesh të organizuara në bashkëpunim me autoritetet tatimore, që kanë pasur si qëllim informimin dhe orientimin e tatimpaguesve lidhur me legjislacionin fiskal. Rëndësia e eventeve të tilla bëhet edhe më e madhe, sidomos kur bëhet fjalë për çështjet e lidhura me Transferimin e Çmimit, i cili është një prej aspekteve më të rëndësishme sa i takon taksimit ndërkombëtar.





# BUSINESS

Dear AmCham member,

Information is the most valuable element when it comes to doing business. It helps you decide on a lucrative contract, an efficient partnership or a better deal. It has become natural to meet new business partners at a trade fair.

Through this new section, we are providing the type of information and contacts that you would only get through a trade fair. American companies are increasingly looking at the Albanian market and seeking partners. As such, this section of the magazine in this issue, and the ones to come in the future, will provide that information. The section's

aim is to provide an ongoing virtual fair to advertise U.S. companies looking for partners. If a profiled American company works in an area of interest for you, then you may have just found a potential partner.

The American Chamber of Commerce, in cooperation with the Economic Office of the U.S. Embassy, will through

this section serve not only an important goal to bring American companies to Albania and boost economic cooperation, but also, above all, it will serve your interests to find the right partners and score successful deals

## KANAWHA SCALES AND SYSTEMS

Kanawha Scales and Systems, a global leader in the manufacturing of scales and automated truck loading systems is looking to enter the Albanian market. The company has been an innovator of loadout systems since the late 1970s, and continues to develop industry leading batch loadout technology. The company has the experience and technology to design, build, install, and support custom loadout systems worldwide for any bulk material. The company has designed and supported over 240 batch weight loadout systems in 10 countries on five continents, used in a wide range of industries. For more information, please visit the company website at: <http://www.kanawhascales.com/>

## WHEELING TRUCK CENTER

Wheeling Truck Center is a full-service Volvo truck dealer located in Wheeling, West Virginia. Wheeling Truck Center deals in new and used trucks, service and parts for all makes of heavy-duty class 8 trucks.

The Wheeling Truck Center is looking to partner with an independent truck spare parts dealer, or to work directly with companies that need spare parts for Volvo trucks. For more information, please visit the company website at: [www.wheelingtruck.com](http://www.wheelingtruck.com)

## ARECONT VISION, LLC

Arecont Vision® is a leading manufacturer of high-performance megapixel IP cameras made in the U.S.

MegaVideo® and SurroundVideo® parallel image processing architectures are now in their fifth generation and represent a departure from traditional analog and network camera designs.

For more information, please visit the company website at: [www.arecontvision.com](http://www.arecontvision.com)

If you have further interest in these company's products and solutions or in partnering with the company, please e-mail Edi Jacellari at [jacellarie@state.gov](mailto:jacellarie@state.gov)



# MATCHING PLATFORM

## I nderuar anëtar i AmCham-it

Elementi më i vlefshëm kur hyn në një biznes është informacioni. Mbi bazën e tij, ju vendosni për kontratën më fitimprurëse, për bashkëpunëtorin më efikas, për marrëveshjen më të mirë. Është bërë e natyrshme që partnerin në biznes ta takosh në një Panair.

Në po tentojmë nëpërmjet kësaj rubrike të re, të sjellim në vëmendjen tuaj ekskluzivitetin e informacionit dhe kontaktet e nevojshme që ju mund t'i merrni vetëm nëpërmjet një Panairi. Kompani amerikane që kanë kthyer kokën nga tregu shqiptar dhe kërkojnë bashkëpunëtorë, do të prezantohen nëpërmjet kësaj rubrike në numrat në vijim. Qël-

limi i saj është të realizojë kryqëzimin e informacionit, për t'ju treguar ju se cilat janë këto kompani, sektori ku bëjnë pjesë dhe bashkëpunëtorit që duan. Nëse për ju profili i kompanisë amerikane përputhet me punën që bëni, keni potencialisht mundësinë për të gjetur një partner biznesi.

Dhoma Amerikane në bashkëpunim me Zyrën Ekonomike të Ambasadës Amerikane i shërbejnë nëpërmjet kësaj rubrike jo vetëm një qëllimi të madh, për të sjellë në vend kompani amerikane dhe për të rritur bashkëpunimin ekonomik, por mbi të gjitha interesit tuaj për të gjetur bashkëpunëtorët e duhur dhe për të lidhur kontratën fituese.

### KANAWHA SCALES AND SYSTEMS

Kanawha Scales and Systems, një lider global në prodhimin e peshoreve dhe sistemeve të ngarkimit automatik të kamionëve, kërkon të hyjë në tregun shqiptar. Kompania ka qenë në krye të përmirësimeve të sistemeve të ngarkesës që prej fundit të viteve '70-të dhe vazhdon të jetë në pararojë të zhvillimeve teknologjike në industrinë e grumbullim-ngarkesave.

Kompania ka përvojën dhe teknologjinë për të dizenuar, ndërtuar, instaluar dhe mbështetur sistemet e ngarkimit të bëra me porosi në mbarë botën për çdo material të rëndë. Kompania ka projektuar dhe mbështetur mbi 240 sisteme grumbullim-ngarkimi në 10 vende në pesë kontinente -- sisteme të përdorura në një gamë të gjerë industrish. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të kompanisë: <http://www.kanawhascales.com/>

### WHEELING TRUCK CENTER

Wheeling Truck Center është një kompani që ofron shitje dhe shërbim të plotë për kamionët Volvo. Me qendër në Wheeling, West Virginia, kompania specializohet në kamionët të rinj dhe të përdorur si dhe shërbime e pjesë këmbimi për të gjithë kamionët e klasës së rëndë të të.

Wheeling Truck Center kërkon të bashkëpunojë me një kompani të pavarur që shet pjesë këmbimi për kamionët ose të punojë drejtpërdrejt me kompani që kanë nevojë për pjesë këmbimi rezervë për kamionët Volvo. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të kompanisë: [www.wheelingtruck.com](http://www.wheelingtruck.com)

### ARECONT VISION, LLC

Arecont Vision® është prodhues kryesor i kamerave IP me megapiksela të performancës së lartë të prodhuara në SHBA.

MegaVideo® dhe SurroundVideo® kanë një arkitekturë të përpunimit të imazhit paralel dhe përfaqësojnë një evoluim të pestë -- larg dezanjtit të kamerave tradicionale analoge dhe në rrjet. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të kompanisë: [www.arecontvision.com](http://www.arecontvision.com)

Nëse keni interes të mëtejshëm për produktet dhe ofertat e këtyre kompanive ose për bashkëpunim me to, ju lutemi dërgoni me e-mail Edi Jacellulari, [jacellulari@state.gov](mailto:jacellulari@state.gov).







**MIRJETA EMINI**  
TRS AT PwC AUDIT ALBANIA

# AMNESTY LAW AND ITS IMPLEMENTATION IN PRACTICE

Approximately 9 months after the issuance of the draft law and after the discussions with the interested parties or disagreements by the opposition, the Albanian parliament adopted law no. 33/2017 "On payment and cancellation of tax liabilities, customs duties, and on procedure for removal from circulation of vehicles after the cancellation of tax liabilities" (Amnesty Law). This law entered into force on 6 May 2017.

## OBLIGATIONS CANCELLED WITHOUT ANY PAYMENT CONDITION

Amnesty Law will allow the cancellation of the liabilities by reducing the debts of the tax and customs administration with that part being actually uncollectible and will help taxpayers by cancelling the obligations that were difficult or impossible to be paid.

Specifically, the Amnesty Law provides for the full cancellation of unpaid tax liabilities (principal, fine, interest) that belong to the tax periods up to 31 December 2010, and are still recorded in the taxpayer's account. This includes also the unpaid local taxes. This cancellation certainly eases the burden of the administration, while also provides relief for taxpayers who carried the obligations through the years. The entire removal of these obligations will, in particular, help those taxpayers who intend to formalize their activity by starting to properly apply the legislation in force.

Customs duties evidenced in the customs administration records by 31 December 2010 will be completely cancelled under the new legislation. This includes the deferred VAT liabilities up to 31 December 2016. Taxpayers should be attentive because the period of cancellation for unpaid VAT liabilities is different and

longer, than the timeframe for other unpaid customs liabilities.

According to the law and the relevant supportive instruction, taxes/local taxes/customs duties must be completely and fully removed from the online system of the administration. Taxpayers should be officially notified for this removal. Hence, taxpayers do not have any obligation to take any preliminary steps regarding the implementation of this part of the law.

Regarding the unpaid social and health insurance obligations that belong to the tax periods until 31 December 2010, the law provides only for the removal of penalties and interest. This treatment is reasonable because this type of obligation always remains payable as it's related to future health and social security benefits. The instruction provides for automatic cancellation of penalties and interest but does not provide any further clarification regarding the principal payment.

## OBLIGATIONS CANCELLED TO THE CONDITION OF PAYING THE PRINCIPAL

Unpaid tax liabilities, local taxes, customs duties, along with unpaid social and health insurance contributions, belonging to the tax periods of January 2011-December

2014, recorded in the taxpayer's account on the date of entry into force of the Amnesty Law, will be removed if certain conditions are met. Specifically, taxpayers must pay the principal within 31 December 2017 in order to benefit from the cancellation of the penalties and interests.

Customs liabilities, which have resulted from the breach of the temporary regime during the period from January 2011 to 31 December 2016, are also to be cancelled on condition that the obligation is paid by 31 December 2017. It is obvious that the period for conditional cancellation of the liabilities related to temporary regime is different from the rest of the customs duties

Taxpayers can make principal payments until the end of 2017. From the provisions of the legislation may be concluded that the taxpayer can make the payment in installments or in full, as long as the principal amount is fully paid by 31 December 2017, in order to benefit from the conditional cancellation.

The law further clarifies that the removal of penalties and interest, applies even if the tax amount has been paid before the entry into force of the Amnesty Law. On the other hand, the respective instruction extends this paragraph by

adding the case when the tax is zero. Yet, the law and the related instruction, are not clear whether the penalties imposed in the period subject to the law relating to the reduction of the credit amount of VAT, during the reimbursement process, are subject to removal or not. We think that these penalties should be cancelled because they are treated as cases with zero tax.

According to the Law, the partial removal of obligations first requires the taxpayer to pay the obligation by 31 December 2017, after which date tax authorities must take the necessary steps to delete penalties and interest from the online system.

While for tax liabilities for which the principal is paid before the entry into force of the Law, penalties and interest are automatically waived, and the taxpayer does not need to take any precautionary actions to benefit from the removal.

## CANCELLATION OF OTHER OBLIGATION

The law provides for cancellation of some other tax liabilities.

What has created confusion among the taxpayers is the cancellation of penalties for non-submitted tax declarations. These penalties will be cancelled to the condition that the taxpayer makes the online declaration by



# LIGJI I FALJES DHE ZBATIMI I TIJ NË PRAKTIKË

Pas afro 9 muaj nga dalja e draft ligjit si dhe pas diskutimeve nga palët e interesuara apo kundërshtimeve nga ana e opozitës, parlamenti shqiptar miratoi Ligjin Nr. 33/2017 "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme doganore, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore" (Ligji i faljes). Ky Ligj hyri në fuqi më 06 Maj 2017.

## DETYRIMET QË FSHIHEN PA KUSHT PAGESE

Ligji i faljes do të bëjë të mundur fshirjen e detyrimeve duke lehtësuar bilancin e administratës tatimore dhe asaj doganore nga ajo pjesë që praktikisht është e pambledhshme si dhe do të ndihmojë tatimpaguesit duke i lehtësuar nga detyrime që i shikonin të vështira për t'i paguar.

Konkretisht, Ligji i faljes parashikon fshirjen e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara (detyrim kryesor/principal, gjobë, kamatëvonesë) të cilat u përkasin periudhave tatimore deri në 31 Dhjetor 2010 dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit. Këtu përfshihen edhe detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sigurisht, që kjo fshirje lehtëson administratën, por edhe tatimpaguesit që i mbajnë ato prej vitesh. Fshirja e plotë e këtyre detyrimeve do të lehtësojë sidomos ata tatimpagues, të cilët kanë qëllimin të formalizojnë aktivitetin e tyre duke zbatuar legjislacionin në fuqi.

Edhe detyrimet doganore të evidentuara në regjistrat e administratës tatimore deri më datë 31 Dhjetor 2010 fshihen plotësisht. Këtu përfshihen edhe detyrimet për TVSH-në e shtyrë, që rezultojnë deri më 31 Dhjetor 2016. Tatimpaguesit duhet të tregohen të vëmendshëm sepse

periudha e fshirjes pa kusht pagese për TVSH-në e shtyrë është e ndryshme (më e gjatë) nga ajo për detyrimet e tjera doganore.

Sipas Ligjit dhe Udhëzimit përkatës, administrata tatimore/vendore/doganore duhet të bëjë fshirjen e plotë të detyrimeve nga sistemi on-line. Tatimpaguesit duhet të njoftohen zyrtarisht në lidhje me këtë fshirje. Pra tatimpaguesit nuk kanë detyrimin të ndërmarrin ndonjë hap paraprak në lidhje me zbatimin e kësaj pjese të ligjit.

Në lidhje me detyrimet e papaguara të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat u përkasin periudhave tatimore deri në 31 Dhjetor 2010, Ligji parashikon vetëm fshirjen e gjobave dhe kamatëvonesave. Ky trajtim është i arsyeshëm pasi detyrimet për to, mbeten gjithnjë të pagueshme përderisa i përkasin përfitimeve të ardhshme shëndetësore dhe pensionale. Udhëzimi parashikon fshirjen automatike të gjobave dhe kamatëvonesave, por nuk jep sqarime të mëtejshme në lidhje me pagesën e principalit.

## DETYRIMET QË FSHIHEN ME KUSHT PAGIMIN E PRINCIPALIT

Detyrimet tatimore, taksat/tarifat vendore, detyrimet doganore si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të

papaguara, të cilat u përkasin periudhave tatimore Janar 2011-Dhjetor 2014, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit të faljes, fshihen me kusht. Specifikisht, tatimpaguesit duhet të paguajnë detyrimin (principal) brenda datës 31 Dhjetor 2017 në mënyrë që të përfitojnë fshirjen/shuarjen e gjobave dhe kamatëvonesave.

Detyrimet doganore për shkelje të regjimit të përkohshëm për periudhën Janar 2011 – 31 Dhjetor 2016 fshihen gjithashtu me kushtin që detyrimi të paguhet brenda datës 31 Dhjetor 2017. Edhe në këtë rast periudha e fshirjes me kusht për regjimin e përkohshëm është e ndryshme nga pjesa tjetër e detyrimeve doganore.

Tatimpaguesit mund të kryejnë pagesën e principalit deri në fund të vitit 2017. Duket që tatimpaguesi mund ta bëjë pagesën me këste ose të plotë, por rëndësi ka që shumica e principalit të paguhet plotësisht brenda datës 31 Dhjetor 2017 në mënyrë që të përfitojë nga fshirja me kusht e detyrimeve.

Ligji sqaron më tej se falja e gjobave dhe kamatëvonesave zbatohet edhe në rast se tatimi/taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të tij. Nga ana tjetër, Udhëzimi i nxjerrë në vijim të Ligjit e zgjeron

këtë paragraf duke shtuar edhe rastin kur tatimi është zero. Nisur nga këto parashikime të Ligjit dhe Udhëzimit, nuk është e qartë nëse gjobat që janë vendosur në periudhën subjekt i Ligjit, të cilat lidhen me ulje të gjendjes kreditore të TVSH-së gjatë procesit të rimbursimit janë subjekt i faljes. Mendojmë që këto gjoba duhet të falen sepse ato trajtohen si rast me tatim zero.

Sipas Ligjit, fshirja pjesore e detyrimeve kërkon fillimisht që tatimpaguesit të kryejnë pagesën e detyrimit brenda datës 31 Dhjetor 2017, dhe pas kësaj date administrata shtetërore duhet të kryejë veprimet e nevojshme për të fshirë nga sistemi on-line gjobat dhe kamatëvonesat.

Ndërsa për detyrime tatimore për të cilat principalit është paguar përpara hyrjes në fuqi të Ligjit, gjobat dhe kamatëvonesat falen automatikisht dhe tatimpaguesi nuk ka nevojë të ndërmarrë ndonjë veprim paraprak për të përfituar nga falja.

## FSHIRJA E DETYRIMEVE TË TJERA

**Ligji parashikon fshirjen e disa detyrimeve të tjera tatimore.**


Ajo që ka krijuar konfuzion tek tatimpaguesit është fshirja e gjobave që lidhen

the 30 June 2017. This time-limit in some cases has been confused with the deadline for the payment of tax liabilities which is 31 December 2017.

It is clear that the deadline for the cancellation of these penalties has already expired. Therefore, taxpayers can no longer benefit from it. The tax administration has published the respective notification in July, and has duly notified the taxpayers that have already benefited from this amnesty.

The law provides for the cancellation of all tax liabilities for the entities deregistered by the National Business Center until the date of its entry into force. This cancellation is necessary and should have been done before by the tax administration for those tax liabilities that were automatically generated from the on-line system, while the entity did not have the obligation to make tax declarations. Cancellation of these liabilities will also improve the situation of uncollectible liabilities.

The law provides for the cancellation of all tax liabilities, registered or not through a tax inspection, which result from the late or no issuance of the authorization for VAT exemption by the National Agency of Natural Resources (AKBN), for applications submitted to the authority until 31 December 2014. We believe that this provision of law is very positive because it has allowed the oil sector to breathe, the companies of which were in conflict with the tax administration for many years. The procedure for issuance of the authorizations was unclear until the new VAT law was issued. Therefore, penalties imposed to companies for absence or delays with the authorizations were unfair. According to the instruction, the tax administration must



follow the necessary procedure; while the taxpayer is required to cooperate in the case of ongoing inspections, by providing the necessary information regarding the dates of applications with AKBN.

### SOME OTHER SPECIFICS OF THE LAW

**The current law like the previous fiscal amnesty laws stipulates the following:**

- Entities will be entitled to the cancellation of tax liabilities (excluding social and health contributions) only after the settlement of the existing tax credit amounts with unpaid obligations. This condition seems unfair because it places taxpayers who have made tax prepayments in unequal terms with the other taxpayers. The taxpayers that have a credit balance, i.e. have

made prepayments to the tax administration will partially benefit from the law, they will only benefit for the part that is not compensated with the tax credit amounts. Meanwhile, the taxpayer who has tax obligations and no prepayments will benefit, to a larger extent, from the law.

- Entities in process of appeal will benefit from the cancellation of taxes/local taxes/customs duties, only if they renounce the appeal process. Taxpayers have found this provision of the law reasonable and have already started to withdraw from the appeal processes. In the meantime, the tax administration has published at the beginning of July the list of taxpayers that are in the process of appeal and can benefit from the law.

It is to be noted that the tax administration has made continuous efforts to raise awareness among taxpayers

and stakeholders on the implementation of the Amnesty Law. Official notifications for all the required steps of the process have been constantly published in its web site. What the interested parties are expecting from the tax administration is to implement the law fully and appropriately.

On the other hand, the taxpayers should pay attention to the terms of the law, particularly the periods for benefiting from cancellation of liabilities because they are different for different types of obligations.

The law is already yielding its positive effects on the taxpayers and on the tax administration in providing relief from previous unpaid obligations. Meanwhile, the Albanian government should continue its efforts to avoid informality and strengthen the rule of law, as a way to raise taxpayers' awareness regarding the declaration and payment of taxes.



me mosdeklarimin në afat për deklaratat tatimore të padorëzuara. Këto gjoba do të fshihen me kushtin që tatimpaguesi duhet të kryente deklarimin on-line brenda datës 30 Qershor 2017. Ky afat në disa raste është ngatërruar me afatin për pagimin e detyrimeve tatimore brenda datës 31 Dhjetor 2017.

Është e qartë që afati për fshirjen e këtyre gjobave tashmë ka përfunduar dhe tatimpaguesit nuk mund të përfitojnë më prej tij. Administrata tatimore ka publikuar në Korrik edhe njoftimin përkatës si dhe ka njoftuar tatimpaguesit që kanë përfituar nga kjo falje.

Ligji parashikon fshirjen e të gjitha detyrimeve tatimore për subjektet e çregjistruara nga Qendra Kombëtare e Biznesit deri në datën e hyrjes në fuqi të tij. Kjo fshirje është e nevojshme dhe duhet të ishte bërë edhe më parë nga ana e administratës tatimore për ato

detyrime tatimore të cilat ishin gjeneruar nga sistemi *on-line* në mënyrë automatike, ndërkohë që subjekti nuk kishte detyrimin të kryente deklarime tatimore. Fshirja e këtyre detyrimeve do të përmirësojë gjithashtu situatën e detyrimeve të pambledhshme në bilancin e administratës tatimore.

Ligji në fjalë përfshin edhe fshirjen e detyrimeve të papaguara, të regjistruara ose jo apo në proces kontrolli, të cilat rezultojnë nga moslëshimi apo lëshimi me vonesë i autorizimit për përjashtim nga TVSH-ja nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), për aplikime të dorëzuara pranë saj deri më 31 Dhjetor 2014. Gjykojmë se ky parashikim i ligjit është mjaft pozitiv sepse u ka dhënë frymëmarrje shoqërive të sektorit të hidrokarbureve, të cilat prej disa vitesh ishin në konflikt me administratën tatimore për mungesën e autorizimeve, apo lëshimin

me vonesë të tyre. Përderisa procedura për lëshimin e autorizimeve nuk ishte e qartë deri në daljen e ligjit të ri të TVSH-së, edhe penalizimi i shoqërive për mungesën/vonesën e autorizimeve duhej i padrejtë. Në bazë të Udhëzimit, administrata tatimore duhet të ndjekë procedurën e nevojshme, ndërsa tatimpaguesit i kërkohet të bashkëpunojë në rastet e kontroleve në proces për të dhënë informacionin e nevojshëm në lidhje me datat e aplikimeve pranë AKBN-së.

### DISA SPECIFIKA TË TJERA TË LIGJIT

**Ligji aktual ashtu si edhe ligjet e mëparshme të faljeve fiskale përcakton si vijon:**

- do të përfitojë pjesërisht nga Ligji, ai përfiton vetëm për pjesën që nuk mbulohet/

kompensohet me gjendjen kreditore. Ndërkohë, një tatimpagues që ka detyrime të mirëfillta tatimore dhe asnjë parapagim do të përfitojë më tepër nga Ligji.

- Subjektet që janë në proces ankimi do të përfitojnë nga fshirja e detyrimeve tatimore/vendore/doganore vetëm nëse heqin dorë nga procesi. Tatimpaguesit e kanë konsideruar të arsyeshme të zbatojnë këtë nen të Ligjit dhe kanë filluar tashmë me tërheqjet nga procesi i ankimit. Administrata tatimore nga ana e saj ka publikuar në fillim të muajit Korrik, listën e subjekteve që janë në proces ankimi dhe që mund të përfitojnë nga Ligji.
- Theksojmë se administrata tatimore ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të sensibilizuar tatimpaguesit dhe palët e interesuara në lidhje me zbatimin e Ligjit të faljes. Në faqen e saj të internetit janë publikuar në mënyrë të vazhdueshme njoftimet përkatëse për çdo hap që lidhet me ligjin. Ajo që pritet tashmë nga administrata tatimore është zbatimi në mënyrë të saktë dhe të plotë i tij në mënyrë që çdo tatimpagues të përfitojë atë që i takon nga ky ligj.

Nga ana tjetër, tatimpaguesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të vecantë afateve të Ligjit, sidomos periudhave të faljes meqënëse ato janë të ndryshme për lloje të ndryshme të detyrimeve.

Ligji po jep tashmë efektet e tij pozitive për tatimpaguesit dhe administratën në lehtësimin nga borxhet e prapambetura. Ndërkohë, qeveria shqiptare duhet të vazhdojë përpjekjet e saj në shmangien e informalitetit dhe forcimin e ligjit, për të ndërgjegjësuar tatimpaguesit në lidhje me deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore.





**ALKETA URUÇI**  
Partner at Boga & Associates

# 2018 FISCAL PACKAGE

On 27 October 2017, the Council of Ministers approved six draft laws, comprising the fiscal package for year 2018.

Below you will find a general overview of the main provisions and novelties introduced by this set of draft laws, the majority of which are expected to enter into force on 1 January 2018.

## VAT

### Incentive in the tourism sector

The draft law proposes the application of a reduced rate of VAT in the amount of 6% for all services offered within the accommodation structures “Five-Star Hotel, Special Status”, as defined in the legislation regulating tourism.

By proposing such amendment, the government seeks to foster the development of tourism sector as well as support the entrance of international well-known hotel brands in the Albanian market.

Other accommodation structures will continue to apply the reduced rate of 6% only for accommodation services. The conditions, criteria and procedures for the implementation of this proposal are to be determined by a decision of the Council of Ministers.

### Lessening compliance costs

The draft law authorizes the Council of Ministers to set different tax periods for a specific category of taxable persons, which can be longer than one calendar month but not exceeding one calendar year.

After entry into force of this provision, it is expected that small businesses shall be

required to file VAT returns on quarterly basis, purporting the lessening of compliance costs for this category of taxpayers.

### VAT threshold

Besides from determining the minimum VAT registration threshold, the Council of Ministers shall also have the right to establish a different VAT threshold for specific categories of taxpayers.

Currently certain professions such as notaries, accountants, engineers etc. are obliged to register for VAT irrespective of their annual turnover.

When the above changes will be approved, it is expected that small businesses having an annual turnover exceeding Leke 2 million will also be required to register for VAT (the annual threshold for VAT registration shall be determined by a forthcoming decision of the Council of Ministers).

## LOCAL TAXES

### General Directorate of Tax on Immovable Properties

The draft law introduces a new public body i.e. the General Directorate of Tax on Immovable Properties (public legal entity under the supervision of the Ministry of Finance and Economy). The structure of this body shall be approved by an order of the Prime Minister, while the Council of Ministers

shall adopt the rules for its organization and functioning.

The main competences of this Directorate will consist in (i) managing the central registry of the fiscal cadaster (established with the purpose of administering the immovable properties tax); (ii) managing the implementation of the immovable properties tax; and (iii) determining the level of tax on buildings using alternative assessment methods (based on criteria and rules to be adopted by a forthcoming Decision of the Council of Ministers).

### Changes of the tax base of the tax on buildings

The draft law proposes a change in the tax base of the tax on buildings, from a fixed amount per each square meter of the buildings’ surface to a percentage over the market value of the building.

The methodology and procedures for determining the market value of buildings shall be determined by the Council of Ministers. The tax on buildings rate, applied as a percentage of the tax base per each year, shall be:

- i. 0.05% for buildings used for dwelling;
- ii. 0.15% for buildings used for economic activity;
- iii. 30% of the respective tax amount for the entire building, for which the developer has failed to

complete the construction within the deadline set forth in the construction permit.

The tax on buildings is paid every month. For specific categories of taxpayers, the Council of Ministers may decide for other payment terms.

### Changes to billboard tax amount

The Council of Ministers proposed changes to the billboard tax. The tax amount depends on the type of billboard (i.e. simple, illuminated, electronic). No tax shall be paid for billboards located at the place of activity of the taxpayer (used for identification purposes) when the billboard does not exceed a surface of 2 square meters.

### Exemption from the tax on new constructions

As an additional incentive for accommodation structures “Five-star hotel, Special Status”, no tax on new constructions shall apply to these new buildings (currently the tax is at a rate between 2% and 4% in Tirana and between 1% and 3% in other municipalities).

# PAKETA FISKALE 2018

Më 27 tetor 2017, Këshilli i Ministrave miratoi gjashtë projektligje, të cilët përbëjnë Paketën Fiskale për vitin 2018. Më poshtë, do të gjeni një informacion të përgjithshëm të dispozitave dhe risive kryesore të prezantuara nga ky grup projektligjesh, pjesa më e madhe e të cilave priten të hyjnë në fuqi më 1 janar 2018.

## TVSH

### Nxitja për sektorin e turizmit

Projektligji propozon zbatimin e një shkalle të reduktuar TVSH-je në masën 6%, për të gjitha shërbimet e ofruara brenda strukturave akomoduese “Hotel me Pesë Yje, Status Special”, siç është përcaktuar në legjislacionin në fushën e turizmit.

Duke propozuar një ndryshim të tillë, qeveria synon të nxisë zhvillimin e sektorit të turizmit, si dhe të mbështesë hyrjen e markave të mirënjohura të hoteleve në tregun shqiptar.

Strukturat e tjera akomoduese do të vazhdojnë të zbatojnë shkallën e reduktuar prej 6% vetëm për shërbimet akomoduese. Kushtet, kriteret, dhe procedurat për zbatimin e këtij propozimi do të vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Lehtësimi i kostove të deklarimit

Projektligji autorizon Këshillin e Ministrave që të vendosë periudha të ndryshme tatimore për kategori të caktuara tatimpaguesish, të cilat mund të jenë më të gjata se një muaj kalendarik, por jo më shumë sesa një vit kalendarik.

Pas hyrjes në fuqi të kësaj dispozite, pritet që bizneseve të vogla t’iu kërkohet të dorëzojnë deklaratat e TVSH-së në baza tremujore, duke synuar kështu lehtësimin e kostove të deklarimit për këtë kategori tatimpaguesish.

### Kufiri i TVSH-së

Përveç përcaktimit të kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në, Këshilli i Ministrave do të ketë të drejtë të zbatojë një kufi TVSH-je të ndryshëm për kategori të caktuara tatimpaguesish.

Aktualisht, disa profesione si noter, kontabilist, inxhinier etj. janë të detyruar të regjistrohen për TVSH-në pavarësisht qarkullimit të tyre vjetor.

Me miratimin e ndryshimeve të mësipërme, pritet që bizneseve të vogla me një qarkullim vjetor i cili kalon vlerën e 2 milion Lekëve, t’iu kërkohet të regjistrohen për TVSH-në (kufiri vjetor për regjistrimin e TVSH-së do të përcaktohet nga një vendim që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave).

## TAKSAT VENDORE

### Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë

Projektligji prezanton një organ të ri publik, i quajtur Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (person juridik publik nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë). Struktura e këtij organi do të miratohet me një urdhër të Kryeministrit, ndërsa Këshilli i Ministrave do të miratojë rregulla për organizimin dhe funksionimin e tij.

Kompetencat kryesore të kësaj Drejtorie do të konsistojnë në (i) menaxhimin e regjistrit qendror të kadastrës fiskale (krijuar me

qëllim administrimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme), (ii) menaxhimin e zbatimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme; dhe (iii) përcaktimin e nivelit të taksës mbi ndërtesat, duke përdorur metodat alternative të vlerësimit (bazuar në kriteret dhe rregulla për t’u miratuar nga një vendim që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave).

### Ndryshimet e bazës së tatueshme për taksën mbi ndërtesat

Projektligji propozon një ndryshim në bazën e tatueshme të taksës mbi ndërtesat, nga një vlerë fikse për çdo metër katror të sipërfaqes së ndërtesës, në një përqindje mbi vlerën e tregut të ndërtesës.

Metodologjia dhe procedurat për përcaktimin e vlerës së tregut të ndërtesave do të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Niveli i taksës mbi ndërtesat, zbatuar si një përqindje e bazës së taksës për çdo vit, do të jetë:

- i. 0.05% për ndërtesat që përdoren për banim;
- ii. 0.15% për ndërtesat që përdoren për veprimtari ekonomike;
- iii. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi nuk ka arritur të përfundojë ndërtimin brenda afatit të përcaktuar në lejen e ndërtimit.

Taksa mbi ndërtesat paguhet çdo muaj. Për kategori të caktuara taksapaguesish, Këshilli

i Ministrave mund të vendosë afate të tjera pagese.

### Ndryshime në nivelin e taksës së tabelës

Këshilli i Ministrave propozoi ndryshime në nivelin e taksës së tabelës. Niveli i taksës varet nga lloji i tabelës (p.sh. e thjeshtë, e ndërçuar, elektronike). Asnjë taksë nuk do të paguhet për tabelat e përdorura për qëllime identifikimi të vendosura në vendin ku tatimpaguesi kryen veprimtarinë e tij, kur tabela nuk tejkalon një sipërfaqe prej 2 metra katrorë.

### Përrjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Si një lehtësi shtesë për strukturat akomoduese “Hotel me Pesë yje, Status Special”, nuk do të zbatohet taksa e ndikimit në infrastrukturë për këto investime (aktualisht, taksa është në shkallën ndërmjet 2% dhe 4% në Tiranë dhe ndërmjet 1% dhe 3% në bashkitë e tjera).

### Procedurat e ankimit kundër taksave vendore

Tatimpaguesit do të kryejnë ankimin kundër vendimeve ose veprimeve të bashkive në strukturën vendore të apelimit tatimor (aktualisht, ankimi kryhet pranë Kryetarit të Bashkisë), sipas kriterëve dhe rregullave të vendosura nga Këshilli Bashkiak. Niveli tjetër i ankimit do të jenë gjykatat administrative.



### Appealing procedures against local taxes

Taxpayers will be required to submit their appeal against decisions or actions of local municipalities to the local tax appeal structure (currently the appeal is filed with the Mayor), according to the criteria and rules to be established by the municipal council. The next appeal level shall be the administrative courts.

## INCOME TAX

### Incentive for the tourism sector

The tourism sector shall be further incentivized with a decrease of the tax on profit to 0% for a 10-year period for accommodation

structures “Four-Star and Five-Star Hotels, Special Status”, benefiting the special status until December 2024. The effects of the exemption shall begin at the commencement of the economic activity, but not later than 3 years after obtaining the special status, in accordance with the applicable law.

### Incentive for the IT sector

For entities operating as software developers, the profit tax shall be reduced from 15% to 5%. The Council of Ministers will define the activities involved in software production / development and the procedures for the implementation of this provision.

## EXCISE TAX

### Increasing of the excise tax for tobacco products

From 1 January 2018, the excise tax for cigarettes containing tobacco will become Leke 5,850/1000 pieces.

## NATIONAL TAXES

The draft law provides for the increase of capacity of cars qualified as luxury cars from 4+1 to 6+1.

In addition, the judiciary fees and tariffs set forth in the law no. 9975/2008 “On National Taxes” are abrogated. The judiciary fees and tariffs will be determined through a specific law.

## CUSTOMS TARIFF

An additional incentive is foreseen for the IT sector. More specifically, the government proposed to reduce certain custom tariffs, applied on import, related to products used in the IT sector.

## ENTRY INTO FORCE

The 2018 Fiscal Package shall enter into force on 1 January 2018, apart from certain provisions affecting local taxes (such as provisions regulating the tax on immovable properties) that shall become effective on 1 April 2018.





## TATIMI MBI TË ARDHURAT

### Nxitja për sektorin e turizmit

Sektori i turizmit do të nxitet më tej me një reduktim të tatimit mbi fitimin në 0% për një periudhë 10 – vjeçare për strukturat akomoduese “Hotele me Katër Yje dhe Pesë Yje, Status Special”, të cilët përfitojnë këtë status special deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit fillojnë në fillim të veprimtarisë ekonomike, por jo më vonë se 3 vjet pas marrjes së statusit special, në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

### Nxitja për sektorin e teknologjisë së informacionit

Për personat juridikë që veprojnë si zhvillues të programeve (software), tatimi mbi fitimin do të ulet nga 15% në 5%. Këshilli i Ministrave do të përcaktojë veprimtaritë e përfshira në prodhimin/ zhvillimin e programeve dhe të procedurave për zbatimin e kësaj dispozite.

## AKCIZA

### Rritja e akcizës për produktet e duhanit

Nga 1 janari 2018, akciza për cigaret të cilat përmbajnë duhan do të bëhet 5.850 Lekë për 1000 copë.

## TAKSAT KOMBËTARE

Projektligji ofron rritjen e kapacitetit të autoveturave të cilësuar si autovetura luksi nga 4+1 në 6+1.

Gjithashtu, tarifatat gjyqësore të vendosura në ligjin nr.9975/2008 “Për Taksat Kombëtare” janë shfuqizuar. Pagesat dhe tarifatat e sistemit gjyqësor do të vendosen nëpërmjet një ligji të veçantë.

## TARIFA DOGANORE

Për sektorin e teknologjisë së informacionit është parashikuar një iniciativë shtesë. Më konkretisht, qeveria propozoi të reduktojë tarifa të caktuara

doganore, të zbatueshme për importin e produkteve të përdorura në sektorin e teknologjisë së informacionit.

## HYRJA NË FUQI

Paketa Fiskale 2018 do të hyjë në fuqi më 1 janar 2018, përveç disa dispozitave që prekin taksat vendore (të tilla si dispozitat që rregullojnë taksat mbi pasuritë e paluajtshme), të cilat do të kenë efekt nga data 1 prill 2018.

abi

AMERICAN BANK  
OF INVESTMENTS

*investo ně optimizem*

[www.abi.al](http://www.abi.al)